



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

LIGJ

Nr. 2/2019

**PËR NJË NDRYSHIM NË LIGJIN NR. 8668, DATË 23.10.2000, “PËR PAJISJEN
E SHTETASVE SHQIPTARË ME PASAPORTË PËR JASHTË SHTETIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 e 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

K U V E N D I

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

V E N D O S I:

Neni 1

Në ligjin nr. 8668, datë 23.10.2000, “Për pajisjen e shtetasve shqiptarë me pasaportë për jashtë shtetit”, të ndryshuar, neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Ripajisja me pasaportë biometrike e shtetasve

1. Shtetasi ripajiset me pasaportë biometrike:
 - a) në rastet e përcaktuara në nenin 9 të këtij ligji;
 - b) kur pasaportës i ka mbaruar afati i vlefshmërisë;
 - c) 6 muaj përpara mbarimit të afatit të vlefshmërisë, kur udhëton apo qëndron përkohësisht në shtete që kushtëzojnë hyrjen ose qëndrimin me afatin 6-mujor të vlefshmërisë së pasaportës.
2. Procedura për ripajisjen me pasaportë biometrike të zakonshme dhe dokumentacioni që paraqitet përcaktohen me udhëzim të Ministrit të Brendshëm.”.

Neni 2

Nxjerrja e akteve nënligjore

Ngarkohet Ministri i Brendshëm që, brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij ligji, të nxjerrë udhëzimin në zbatim të nenit 1 të këtij ligji.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

K R Y E T A R I

Gramoz RUÇI

Miratuar në datën 31.1.2019